

RAPORTI VJETOR 2024

HANDIK&S

SHOQATA E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR - HANDIKOS FERIZAJ
ASSOCIATION OF PERSONS WITH DISABILITY - HANDIKOS FERIZAJ

PARATHËNIE

Handikos Ferizaj është organizatë jo-qeveritare e përkushtuar në rritjen e mirëqenies dhe pavarësimin e personave me aftësi të kufizuara, përmes ofrimit të shërbimeve sociale dhe avokimit.

Handikos Ferizaj punon për së afërmi me komunitetin, organizata të tjera si-motra, institucionet shëndetësore dhe autoritetet lokale e qendrore, për t'i shërbyer në mënyrë sa më efektive dhe të qëndrueshme përfituesve të saj.

HISTORIKU

Handikos Ferizaj ka qenë pjesë e HANDIKOS-it e cila është themeluar në vitin 1983 dhe fillimisht ka qenë e emëruar si Shoqata e Paraplegjikëve dhe Paralizës së Fëmijëve e Kosovës. Gjatë fazes emergjente të pas-luftës, HANDIKOS-i është shndërruar në ofrues të shërbimeve duke tentuar të mbulojë disa nga nevojat e personave me aftësi të kufizuara. Me këtë rast, HANDIKOS ka ofruar materiale ortopedike, sanitare dhe materiale për parandalimin e plagëve dekubitare. HANDIKOS ka vepruar në tërë Kosovën dhe ka ofruar shërbimet e njëjta për të gjitha komunitetet pa dallim etnie, feje dhe race. Dega në Ferizaj, së bashku me të gjitha degët e tjera të HANDIKOS-it, që nga viti 2015 është pavarësuar në aspektin administrativ e programor nga qendra në Prishtinë dhe tani është e regjistruar si OJQ në vete. Kjo shkëputje është bërë me planifikim paraprak me qëllim të forcimit organizativ të qendrave gjithandej Kosovës, rritjes së qëndrueshmërisë së shërbimeve të ofruara me bazë në komunitet dhe përmbushjes së nevojave të përfituesve në mënyrë më efikase.

VIZIONI:

Shoqëri gjithëpërfshirëse me njohje dhe realizim të plotë të të drejtave dhe mundësive të barabarta të personave me aftësi të kufizuara.

MISIONI:

Handikos Ferizaj është organizatë jo-qeveritare që punon në rritjen e mirëqenies dhe pavarësimin e personave me aftësi të kufizuara, përmes avokimit dhe ofrimit të shërbimeve sociale.

OBJEKTIVAT STRATEGJIKE:

Duke u bazuar në analizën e situatës së personave me aftësi të kufizuara, Handikos Ferizaj e sheh si të nevojshme që organizata të përqendrohet në tri objektiva kryesore strategjike.

Këto tri objektiva janë:

1. Përmirësimi i politikave publike dhe rritja e zbatimit të ligjeve e strategjive relevante për personat me aftësi të kufizuara.
2. Rritja e cilësisë dhe njeherit zgjerimi i shërbimeve të ofruara me bazë në komunitet.
3. Rritja e pjesëmarrjes së personave me aftësi të kufizuara në tregun e punës

Synimet tona kryesore gjatë 2024-ës kanë qenë të fokusuar në pesë (5) objektiva:

- ✚ Avokimi dhe lobimi drejt mbrojtjes dhe avancimit të të drejtave të personave me aftësi të kufizuara.
- ✚ Ofrimin e shërbimeve për fëmijë dhe të rritur me aftësi të kufizuara, të cilat janë primare dhe më se të nevojshme por që ende mbesin një sfidë;
- ✚ Mbështetja e personave me aftësi të kufizuara dhe familjeve të tyre me mjete assistive;
- ✚ Ngritja e kapaciteteve të personave me aftësi të kufizuara mbi të drejtat e tyre dhe personelit të Handikos Ferizaj.
- ✚ Ndërtimi i Qendrës së Re me Bazë në Komunitet, Handikos Ferizaj. Qendra do të jetë një pikë e rëndësishme për zhvillimin e aktiviteteve profesionale, edukative dhe sociale, që do të ndihmojnë individët të arrijnë pavarësinë dhe përmbushjen e potencialeve të tyre.

PËRMBLEDHJE

Personat me aftësi të kufizuara në Kosovë përballen me një sërë sfidash dhe barrierash të ndryshme që ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë e jetës së tyre. Sfidat kryesore mbeten fushat e **qasjes, edukimit, punësimit, mirëqenies dhe respektimit dhe avancimit të të drejtave të tyre**. Këto vështirësi janë të lidhura ngushtë me legjislacionin e vendit, por gjithashtu janë të ndikueshme edhe nga standardet dhe dokumentet ndërkombëtare që promovojnë të drejtat e personave me aftësi të kufizuara.

Në kontekstin e Kosovës, legjislacioni i miratuar për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, ndonëse ka bërë hapa të rëndësishëm për avancimin e statusit të këtij grupi, ende nuk është plotësisht i zbatueshëm dhe nuk ofron një mbështetje të mjaftueshme për të garantuar të drejtat dhe mundësitë e barabarta. Ndërsa dokumentet ndërkombëtare, si **Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe agjendat e tjera ndërkombëtare**, ofrojnë korniza dhe standarde të qarta, implementimi i tyre në praktikë mbetet një sfidë.

Një ndër shembujt më konkretë të këtyre vështirësive është edhe **Handikos Ferizaj**, që mbështet personat me aftësi të kufizuara. Handikos Ferizaj, ndonëse ka arritur të realizojë një sërë projektesh të rëndësishme që ndihmojnë këtë grup, përballat vazhdimisht me mungesën e një mbështetjeje të qëndrueshme dhe të përhershme nga institucionet lokale dhe atyre qendrore. Kjo e bën të vështirë për Handikos Ferizaj të ofrojë shërbime afatgjata dhe të vazhdueshme për personat me aftësi të kufizuara, pasi organizata është e detyruar të mbështetet 100% në projekte të financuara nga donatorë dhe burime të jashtme, që shpesh janë të kufizuara dhe të pasigurta.

Një prej fushave ku kjo mungesë mbështetjeje është më e dukshme është në ofrimin e

shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara. Ndërkohë që disa shërbime mbulohen nga sektorët e ndryshëm, ende ka mangësi të konsiderueshme në ofrimin e shërbimeve të specializuara nga institucionet lokale dhe vendore. Kjo ka krijuar një hendek në nevojat e përditshme të personave me aftësi të kufizuara dhe i ka detyruar ata të kërkojnë mbështetje nga organizata të tilla si Handikos, të cilat shpesh janë të varura nga projekte të përkohshme, pa një mbështetje të garantuar dhe të qëndrueshme.

Për më tepër, **barrierat fizike dhe mjedisore**, si mungesa e aksesit në hapësira publike dhe transport, dhe **mangësitë në edukim dhe punësim**, mbeten gjithashtu shqetësime të mëdha për personat me aftësi të kufizuara. Pavarësisht përpjekjeve për të promovuar përfshirjen dhe mundësitë e barabarta, shumë individë ende nuk kanë mundësi për të zhvilluar aftësitë e tyre dhe për të kontribuar aktivisht në shoqëri. Kjo krijon një cikël të pafavorshëm ku personat me aftësi të kufizuara mbeten të marginalizuar, ndërsa institucionet lokale dhe autoritetet janë të pasigurta në ofrimin e mbështetjes që u nevojitet.

Në përfundim, për të siguruar një përfshirje të plotë dhe të barabartë të personave me aftësi të kufizuara, është e nevojshme një angazhim i fuqishëm dhe i qëndrueshëm nga **Komuna e Ferizajt** dhe institucionet vendore. Duhet të sigurohet mbështetje e vazhdueshme për organizatat si **Handikos Ferizaj**, që ofrojnë shërbime dhe mbështetje, dhe të krijohen mundësi të reja për punësim, arsim dhe akses në shërbime për këtë grup. Vetëm përmes një koordinimi të plotë dhe një mbështetjeje më të madhe nga autoritetet lokale mund të avancohen të drejtat dhe mundësitë për personat me aftësi të kufizuara, duke siguruar një shoqëri të barabartë dhe të drejtë për të gjithë.

“Çdo person, pavarësisht kufizimeve që mund të ketë, ka potencialin për të kontribuar në zhvillimin e shoqërisë dhe shtetit tonë. Duhet të ofrojmë mundësi të barabarta për të shprehur aftësitë dhe talentet e tyre, duke u mundësuar atyre të arrijnë pavarësinë dhe suksesin që meritojnë. Përmes integritetit dhe mbështetjes, ne e forcojmë shoqërinë në tërësinë e saj”

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Raporti Vjetor i Handikos Ferizaj për vitin 2024 paraqet një pasqyrë të hollësishme dhe të thelluar të arriturve të organizatës gjatë vitit 2024, duke pasqyruar përkushtimin dhe angazhimin e saj në avancimin e kushteve për personat me aftësi të kufizuara. Ky raport mbështetet në të dhënat dhe arritjet e dokumentuara gjatë implementimit të projekteve të mbështetura nga donatorë vendorë dhe ndërkombëtarë, duke ofruar një pasqyrë të qartë të ndikimit të këtyre aktiviteteve.

Në vitin 2024, Handikos Ferizaj ka vazhduar të ofrojë shërbime të shumta dhe të specializuara për individë me aftësi të kufizuara, si dhe për prindërit dhe familjarët e tyre. Këto shërbime kanë përfshirë mbështetje direkte për fëmijët dhe të rriturit me aftësi të kufizuara, si dhe mundësi trajnimi dhe mbështetje psikologjike për ata që kujdesen për këta individë.

Përmes aktiviteteve dhe projekteve të realizuara, Handikos Ferizaj ka pasur një ndikim të madh në përmirësimin e kushteve të jetesës dhe integrimin social të personave me aftësi të kufizuara në shoqëri. Përmes një angazhimi të pandërprerë, organizata ka vazhduar të kontribuojë në ndërtimin e një shoqërie më të drejtë dhe përfshirëse, duke siguruar që të drejtat dhe nevojat e personave me aftësi të kufizuara të trajtohen me seriozitet dhe përkushtim.

Ky raport është një pasqyrë e angazhimit të Handikos Ferizaj për një të ardhme më të ndritshme dhe të drejtë për të gjithë.

Gjatë vitit 2024, Handikos Ferizaj ka ofruar një gamë të gjerë shërbimesh për fëmijët me aftësi të kufizuara, duke mbështetur ata në mënyra të ndryshme që ndikojnë drejtpërdrejt në përmirësimin e kushteve të jetesës dhe realizimin e të drejtave të tyre. Pika kryesore ka qenë ofrimi i shërbimeve të drejtpërdrejta për **65** fëmijë me aftësi të kufizuara, duke realizuar gjithsej **1850** shërbime të specializuara, që përfshijnë mbështetje edukative, rehabilituese dhe sociale.

Njëkohësisht, janë ofruar shërbime të pajisjeve ndihmëse për **113** persona me aftësi të kufizuara në komunën e Ferizajt, për të lehtësuar lëvizjen dhe përmirësuar cilësinë e jetës së tyre. Kjo përfshin pajisje ortopedike, ndihmës dhe teknologji asistive që mundësojnë pavarësi më të madhe dhe integrim në shoqëri. Për më tepër, Handikos Ferizaj ka luajtur një rol të rëndësishëm në mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara përmes këshillave ligjore dhe mbështetjes në zgjidhjen e çështjeve të ndryshme ligjore që ata mund të përballen. Gjatë vitit, janë ofruar gjithsej 78 këshilla ligjore për individët me aftësi të kufizuara, ndërkohë që **23** prej tyre kanë përfshirë ankesa, që tregojnë se Handikos Ferizaj ka ndihmuar individët në mbrojtjen e të drejtave të tyre përmes procedurave ligjore dhe administrative. Në këtë mënyrë, Handikos Ferizaj ka kontribuar në forcimin e të drejtave të njeriut dhe ka ofruar mbështetje të nevojshme për të siguruar integrimin e plotë të personave me aftësi të kufizuara në shoqëri, duke i mundësuar atyre të jetojnë një jetë më të barabartë dhe të dinjitetshme.

Handikos Ferizaj ka vazhduar të mbajë një bashkëpunim të ngushtë me organizatat e shoqërisë civile, organizatat që mbrojnë të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, organizatat ndërkombëtare, si dhe institucionet lokale dhe qendrore. Ky bashkëpunim ka pasur ndikim të drejtpërdrejtë në përmirësimin e kushteve të jetesës për personat me aftësi të kufizuara, duke adresuar nevojat e tyre dhe avancuar pozitat e tyre në shoqëri. Handikos Ferizaj vazhdon të punojë me përkushtim për të krijuar një shoqëri gjithëpërfshirëse, ku të drejtat e njeriut të personave me aftësi të kufizuara njihen dhe realizohen plotësisht.

Edhe pse mungojnë statistikat lokale që pasqyrojnë numrin dhe përhapjen e aftësisë së kufizuar në vend, Handikos Ferizaj ka mbi 1047 anëtarë të regjistruar, të cilët kanë aftësi të kufizuara fizike dhe të

kombinuara, dhe përfaqësojnë të gjitha moshat, gjinish dhe grupe etnike. Vetëm këtë vit, janë regjistruar **22** raste të reja.

PROJEKTET QË HANDIKOS FERIZAJ KA IMPLEMENTUAR PËRGJATË VITIT 2024

- **Angazhimi i të rinjve, për një shoqëri gjithëpërfshirëse pa diskriminim** – mbështetur nga Ministria e Pushtetit Lokal dhe Komuna e Ferizajt.

OBJEKTIVAT:

- Fuqizimi i të rinjve me aftësi të kufizuara duke u dhënë mundësinë për të zhvilluar dhe rritur aftësitë e tyre për punësim dhe vetëpunësim.
- Ndërgjegjësimin e të rinjve me aftësi të kufizuara në çështjen e mbrojtjes së ambientit.
- Krijimi i veprave të artit përmes riciklimin e materialeve të vjetra, dhe këto vepra do të promovojnë mesazhin e mbrojtjes së mjedisit.

- **Arti ynë tejkalon kufizimet** - mbështetur nga Ministria për Kulturë, Rini dhe Sport.

OBJEKTIVAT:

- Të inkurajohen personat me aftësi të kufizuara të zhvillojnë vetë-besimin duke i mbështetur ata të shprehin veten nëpërmjet artit dhe kulturës.
- Të ndihmohet në ndërtimin e lidhjeve sociale dhe miqësore mes personave me aftësi të kufizuara dhe bashkëmoshatarëve pjesëmarrës në aktivitete.
- Të promovohet bashkëpunimi dhe partneriteti mes organizatave lokale, institucioneve kulturore dhe komunitetit të biznesit për të siguruar një përmbushje të qëllimeve të qarta dhe të rëndësishme për përmirësimin e jetës sociale dhe përfshirjes së personave me aftësi të kufizuara në shoqëri.
- Fuqizimin e të rinjve/fëmijëve me aftësi të kufizuara duke u dhënë mundësinë për ngritjen dhe zhvillimin e aftësive të tyre nëpërmjet artit.

- **Zhvillimi i kapaciteteve të fëmijëve me aftësi të kufizuara** - mbështetur nga Ministria e Drejtësisë

OBJEKTIVAT:

- Zhvillimi i aftësive të reja tek fëmijët me aftësi të kufizuara, rritja e pavarësisë në aktivitetet e përditshme dhe rritja e qasjes në arsim duke rritur mundësitë e vijimit të mesimit në shkollat e rregullta dhe arsimim cilësor.
- Prindërve/kujdestarëve të fëmijëve me AK do t'u ofrohet informacion, burime dhe mbështetje për t'i ndihmuar të kuptojnë më mirë aftësinë e kufizuar të fëmijëve të tyre dhe plotësimin e nevojave që ata kanë për të zhvilluar potencialin e tyre të plotë dhe njëkohësisht duke i fuqizuar të avokojnë edhe për të drejtat e fëmijëve të tyre.
- Institucione më të qasshme dhe gjithëpërfshirëse, duke u ofruar fëmijëve me aftësi të kufizuara mundësi të barabarta për të marrë pjesë në aktivitete edukative, sociale dhe rekreative.

- **"Piloting of family-centered Early Childhood Intervention services in five selected municipalities"**, të implementuar nga HANDIKOS (Prishtinë) në bashkëpunim me Handikos Ferizaj dhe mbështetur nga UNICEF

- **OBJEKTIVAT:**

- Ofërimi i shërbimeve në fëmijërinë e hershme është një koncept që lidhet me ofrimin e mbështetjes dhe kujdesit të duhur për zhvillimin e fëmijëve nga mosha e lindjes deri në

moshën e parashikuar për fillimin e shkollës. Ky proces përfshin shërbime edukative, shëndetësore, psikologjike dhe sociale që kanë për qëllim të ndihmojnë në rritjen e fëmijëve të shëndetshëm dhe të zhvilluar si individë të plotë.

- **“Aktivizim, Qasje të Barabartë për Personat me Aftësi të Kufizuara në Trashëgiminë Kulturore të Kosovës”** - mbështetur nga Ministria për Kulturë, Rini dhe Sport.

OBJEKTIVAT:

- Hulumtim i objekteve kulturore mbi qasjen për persona me aftësi të kufizuara
 - Hartimin e planit të veprimit për përmirësimin e qasjes për persona me aftësi të kufizuara.
 - Aktivitete socializuese (vizita të Muzeumeve rajonale dhe Muzeume të Përgjithshme)
- **"Mbështetje Gjithëpërfshirëse për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara përmes Fizioterapisë dhe Rehabilitimit"** mbështetur nga - Zyra e Presidentes

OBJEKTIVAT:

- Ofrimi i shërbimeve të individualizuara të fizioterapisë:
 - Përmirësimi i aftësive motorike dhe funksionale:
 - Rritja e pavarësisë në aktivitetet e përditshme:
 - Edukimi i prindërve dhe kujdestarëve:
- **“Zhvillimi i kapaciteteve të fëmijëve me aftësi të kufizuara”** mbështetur nga - Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

OBJEKTIVAT:

- Zhvillimi i aftësive të reja tek fëmijët me aftësi të kufizuara, rritja e pavarësisë në aktivitetet e përditshme dhe rritja e qasjes në arsim duke rritur mundësitë e vijimit të mësimin në shkollat e rregullta dhe arsimin cilësor.
- Prindërve/kujdestarëve të fëmijëve me AK do tu ofrohet informacion, burime dhe mbështetje për ti ndihmuar të kuptojnë më mirë aftësinë e kufizuar të fëmijëve të tyre dhe plotësimin e nevojave që ata kanë për të zhvilluar potencialin e tyre të plote dhe njëkohësisht duke i fuqizuar të avokojnë edhe për të drejtat e fëmijëve të tyre.
- Institucione më të qasshme dhe gjithëpërfshirëse, duke u ofruar fëmijëve me aftësi të kufizuara mundësi të barabarta për të marrë pjesë në aktivitete edukative, sociale dhe rekreative.

Komuna e Ferizajt është e angazhuar në vazhdimin e mbështetjes për pagesën e qirasë edhe gjatë vitit 2024, duke siguruar stabilitet dhe qëndrueshmëri në ofrimin e shërbimeve të nevojshme për fëmijët me aftësi të kufizuara. Kjo mbështetje është një hap i rëndësishëm për të garantuar akses të barabartë në arsim, terapi dhe aktivitete zhvillimore për këta fëmijë, duke mundësuar një ambient të përshtatshëm për përfshirjen dhe mirëqenien e tyre.

Po ashtu, Komuna ka siguruar transportin për mjetet asistive, duke lehtësuar ndjeshëm qasjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara në pajisjet e domosdoshme për lëvizshmërinë dhe pavarësinë e tyre. Ky angazhim është dëshmi e përkushtimit për krijimin e një mjedisi më gjithëpërfshirës dhe përmirësimin e cilësisë së jetës për këtë kategori, duke u siguruar që asnjë fëmijë të mos mbetet pa mbështetjen e nevojshme.

RAPORTI MBI SHËRBIMET DHE AKTIVITETET E HANDIKOS FERIZAJ PËR VITIN 2024

Raporti mbi Shërbimet, gjatë vitit 2024, Handikos Ferizaj ka ofruar një gamë të gjerë shërbimesh dhe aktivitete që janë fokusuar në përmirësimin e kushteve të jetesës së fëmijëve dhe në realizimin e të drejtave të tyre, duke siguruar mbështetje të drejtpërdrejtë për 65 fëmijë me aftësi të kufizuara.

Në total, janë realizuar 1850 shërbime të specializuara, që përfshijnë disa lloje shërbimesh për të mbështetur zhvillimin e fëmijëve në aspekte të ndryshme. Shërbimet e ofruara kanë përfshirë:

- **Mbështetje psikologjike:** Kjo ka pasur si qëllim mbështetjen emocionale dhe mendorë të fëmijëve, për t'i ndihmuar ata të përballen me sfidat që hasin në jetën e përditshme.
- **Edukimi joformal:** Aktivitetet edukative jashtë sistemit formal shkollor që kanë ofruar mundësi zhvillimi të aftësive sociale, mendore dhe kulturore për fëmijët.
- **Logopedi:** Shërbimi i logopedisë ka ndihmuar fëmijët për të përmirësuar aftësitë e tyre të komunikimit dhe të shprehjes, duke i mundësuar atyre të zhvillojnë aftësi më të mira në të folur dhe dëgjim.
- **Fizioterapi dhe Ergoterapi:** Shërbimet rehabilituese përmirësojnë lëvizshmërinë dhe aftësinë për t'u angazhuar në aktivitete të përditshme, si dhe ndihmojnë në zhvillimin e aftësive fizike dhe motorike të fëmijëve.



Këto shërbime janë ofruar për të ndihmuar fëmijët të përballen me sfidat e jetës dhe të përmirësojnë cilësinë e jetës së tyre. Aktivitetet e Handikos Ferizaj janë të orientuara drejt përfshirjes sociale të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe mbështetjes së tyre për të arritur potencialin e plotë, duke u ofruar mundësi për zhvillimin e aftësive të nevojshme në të gjitha fushat e jetës.

SHËRBIMET PSIKOLOGJIKE

Shërbimet psikologjike për fëmijë janë një aspekt shumë i rëndësishëm i mbështetjes emocionale dhe zhvillimit të tyre mendor. Ky grup prej 18 fëmijësh që kanë përfituar nga këto shërbime përfshin 10 djem dhe 8 vajza, dhe gjithsej ata kanë marrë 271 shërbime psikologjike. Ky është një numër i konsiderueshëm i shërbimeve, që tregon përkushtimin e sistemit të mbështetjes dhe kujdesit për fëmijët.

Ndër këto shërbime, 104 shërbime janë ofruar për vajza, ndërsa 167 për djem, duke u pasqyruar kështu nevojat e ndryshme të çdo grupi. Kjo mund të tregojë për rëndësinë e ofrimit të shërbimeve të personalizuar që janë të përshtatshme për secilin individ dhe që marrin parasysh karakteristikat e ndryshme të zhvillimit të fëmijëve.

Shërbimet psikologjike për fëmijët mund të përfshijnë një gamë të gjerë aktivitetesh, si seanca këshilluese, mbështetje për zhvillimin e aftësive sociale, ndihmë për përballimin e stresit ose emocioneve të tjera të vështira, si dhe mbështetje për trajtimin e problemeve të mundshme mendore apo emocionale që mund të shfaqen gjatë moshës së fëmijërisë.



SHËRBIME TË EDUKIMIT JOFORMAL


Në vitin 2024, shërbimet e edukimit joformal janë ofruar për gjithsej **19 fëmijë**, të cilët kanë marrë pjesë në një gamë të gjerë aktiviteteve edukative jashtë sistemit formal të arsimit. Këto shërbime janë organizuar për të ofruar mundësi zhvillimi për fëmijët në fusha të ndryshme si aftësitë sociale, kreative, kulturore dhe profesionale. Qëllimi kryesor ka qenë të ofrohen mundësi për rritjen dhe zhvillimin e fëmijëve, duke i ndihmuar ata të zhvillojnë aftësi të reja dhe të përgatiten për sfida të ardhshme.

Në vitin 2024, shërbimet e edukimit joformal janë ofruar për gjithsej **19 fëmijë**, prej të cilëve **16 janë djem** dhe **3 janë vajza**.

Në total, janë realizuar **245 shërbime**, ku:

- **208 shërbime** janë përfituar nga djemtë.
- **37 shërbime** janë përfituar nga vajzat.

Shërbimet janë realizuar në mënyrë të tillë që çdo fëmijë të përfitonte mundësi zhvillimi dhe angazhimi në aktivitete të ndryshme edukative, që kanë për qëllim mbështetje për aftësitë sociale, intelektuale dhe krijuese të fëmijëve. Aktivitetet kanë përfshirë grupe të ndryshme moshash dhe interesash, duke pasur për qëllim përfshirjen e gjithë fëmijëve në procesin e edukimit joformal dhe rritjen e mundësive për zhvillim të barabartë për të gjithë ata që kanë marrë pjesë.



SHËRBIMET LOGOPEDIKE

Gjatë vitit 2024, është ofruar mbështetje e specializuar për fëmijët me vështirësi në të folur, me qëllim përmirësimin e komunikimit dhe zhvillimin e aftësive gjuhësore. Programet e logopedisë kanë qenë të orientuara për të ndihmuar fëmijët që të përmirësojnë aftësitë e tyre në të folur dhe të zhvillojnë më tej mundësitë për ndërveprim të suksesshëm me të tjerët në nivel social dhe komunikativ.

Në këtë vit, mbështetja logopedike është ofruar për gjithsej **16 fëmijë**, nga të cilët **13 janë djem** dhe **3 janë vajza**, janë realizuar gjithsej **234 shërbime logopedike**, të cilat kanë ofruar mundësi të vazhdueshme për fëmijët që të punojnë me specialistët dhe të zhvillojnë aftësitë e nevojshme për përmirësimin e të folurit dhe komunikimit. Këto shërbime kanë përfshirë aktivitete që ndihmojnë fëmijët të përmirësojnë artikullimin, zhvillimin e fjalorit, dhe aftësinë për të krijuar fjali të plota dhe të kuptueshme.

Programet e logopedisë kanë ofruar gjithashtu mundësi për rritjen e vetëbesimit të fëmijëve, duke i ndihmuar ata të ndihen më të sigurt në shprehjen e mendimeve dhe emocioneve të tyre, si dhe në ndërveprimin me mjedisin përreth. Këto shërbime kanë ndikuar në përmirësimin e integritit të fëmijëve në aktivitete të tjera edukative dhe sociale, duke kontribuar në zhvillimin e përgjithshëm të tyre.

Në përfundim, mbështetja logopedike gjatë vitit 2024 ka pasur një ndikim pozitiv në zhvillimin gjuhësor të fëmijëve, duke ofruar mundësi për përmirësimin e komunikimit dhe ndërveprimit të tyre me të tjerët. Këto shërbime kanë ndihmuar fëmijët të përmirësojnë aftësitë e tyre dhe të krijojnë mundësi më të mira për të qenë të përfshirë në shoqëri.




SHËRBIME FIZIOTERAPEUTIKE

Gjatë vitit 2024, për shkak të mungesës së mbështetjes financiare, shërbimet e fizioterapisë dhe ergoterapisë janë ofruar për një periudhë më pak se tre muaj, duke kufizuar ndjeshëm aksesin e fëmijëve me aftësi të kufizuara në terapi të specializuara. Gjatë kësaj periudhe të kufizuar, 11 fëmijë – 7 vajza dhe 4 djem – kanë përfituar nga këto shërbime, duke marrë gjithsej 88 seanca terapeutike, nga të cilat 56 seanca u janë ofruar vajzave dhe 32 djemve.

Kufizimi i këtyre shërbimeve ka ndikuar drejtpërdrejt në progresin dhe mirëqenien e fëmijëve që kanë nevojë për terapi të vazhdueshme për zhvillimin e tyre fizik dhe motorik. Fizioterapia dhe ergoterapia janë jetike për përmirësimin e aftësive motorike, reduktimin e dhimbjeve dhe rritjen e pavarësisë funksionale të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Mosvazhdimi i këtyre seancave mund të çojë në regres në zhvillimin e tyre dhe të kufizojë mundësitë për një jetë më të pavarur dhe të integruar në shoqëri.

Në këtë kontekst, është e domosdoshme sigurimi i mbështetjes së qëndrueshme financiare për të garantuar ofrimin e vazhdueshëm të shërbimeve terapeutike. Nevojiten burime të qëndrueshme për të zgjeruar gamën e shërbimeve dhe për të përfshirë një numër më të madh përfituesish, duke mundësuar trajtime më të shpeshta dhe të personalizuara sipas nevojave specifike të secilit fëmijë. Bashkëpunimi me institucionet publike dhe private, organizatat joqeveritare dhe donatorët është thelbësor për të siguruar mbështetje afatgjatë dhe për të krijuar një sistem më të qëndrueshëm të shërbimeve rehabilituese.

Puna individuale dhe në grup ka përfshirë aktivitete të dizajnuara për të ndihmuar fëmijët në zhvillimin e aftësive motorike dhe në rritjen e pavarësisë funksionale. Këto aktivitete kanë kontribuar në përmirësimin e koordinimit të lëvizjeve dhe forcimin e aftësive për realizimin e aktiviteteve të përditshme.



SEANCA GRUPORE DHE AKTIVITETE SOCIALE

Janë mbajtur 15 seanca grupore me pjesëmarrjen e 30 fëmijëve, gjatë të cilave janë trajtuar tema të rëndësishme për zhvillimin e tyre social dhe emocional. Këto seanca kanë ofruar mundësi për fëmijët të diskutojnë dhe të zhvillojnë aftësi për t'u përballur me sfida sociale dhe emocionale, duke kontribuar në forcimin e marrëdhënieve ndërpersonale dhe rritjen e vetëdijes emocionale.

Komunikimi. Ky është një aspekt kyç për ndërtimin e marrëdhënieve të shëndetshme dhe për të ndihmuar fëmijët të shprehin mendimet dhe emocionet e tyre në mënyrë të qartë dhe me respekt për të tjerët. Duke përdorur role-play ose diskutime grupore, fëmijët praktikojnë si të shprehin nevojat e tyre, të dëgjojnë dhe të kuptojnë ndjeshmërinë ndaj të tjerëve.

Menaxhimi i stresit dhe emocionet. Nëpërmjet ushtrimeve të frymëmarrjes, meditimit të thjeshtë, ose teknikave të relaksimit, fëmijët mësojnë se si të kontrollojnë emocionet e tyre në situata të tensionuara, si për shembull gjatë konflikteve me shokët e klasës ose kur përballen me presionin e mësimeve.

Bashkëpunimin në grup. Pjesëmarrja në aktivitete grupore, si lojra, projekte të përbashkëta nxisin aftësitë e fëmijëve për të punuar së bashku, për të mbështetur njëri-tjetrin, dhe për të ndihmuar në krijimin e një atmosfere mbështetëse dhe të sigurt.

Qëllimi i këtyre seancave është të forcohet **vetëvlerësimi dhe vetëdija emocionale** e fëmijëve. Ata duhet të kuptojnë më mirë se si të njohin emocionet e tyre, t'i menaxhojnë ato dhe të zhvillojnë një nivel të lartë të vetëbesimit, që është i nevojshëm për t'u përballur me sfidat e jetës dhe për të krijuar marrëdhënie të shëndetshme me të tjerët.

Në përgjithësi, këto seanca kanë kontribuar në zhvillimin e fëmijëve në mënyrë të balancuar, duke i mbështetur ata të rriten si individë emocionalisht të shëndetshëm dhe të aftë për të pasur marrëdhënie pozitive dhe të qëndrueshme me të tjerët.



SEANCAT DHE AKTIVITETET GRUPORE ME TË RRIUR

Seancat dhe aktivitetet grupore me të rritur janë një mundësi për t'u angazhuar në mënyra të ndryshme, që ndihmojnë në zhvillimin personal, forcimin e bashkëpunimit dhe rritjen e aftësive sociale. Këto aktivitete mund të jenë të llojeve të ndryshme, si psikoterapi grupore, trajnime për aftësi të reja, ose aktivitete që përfshijnë aktivitete fizike dhe kreative. Ja disa ide dhe formate të mundshme:

Seanca psikologjike grupore:

Qëllimi: Të ofrohet mbështetje emocionale dhe psikologjike. Psiko terapistët udhëheqës ndihmojnë grupin të zhvillojë aftësi për të menaxhuar stresin, ankthin dhe depresionin, përmes diskutimeve të hapura mbi përvojat personale, roli i mbështetjes reciproke, teknika për menaxhimin e emocioneve dhe zhvillimin e vetëvlerësimit.

Trajnime për aftësi të reja:

Qëllimi: Të ndihmohet grupi të zhvillojë aftësi profesionale dhe personale që mund të përdoren në jetën e përditshme, përmes trajnimeve në menaxhimin e kohës dhe efektivitetin në punë dhe kurseve për zhvillimin e aftësive të komunikimit dhe prezantimit.

Workshop-e për krijimin e CV-së dhe përgatitjen për intervista pune.

Handikos Ferizaj ka organizuar një trajnim dyditor për të rinjtë me aftësi të kufizuara, fokusuar në zhvillimin e aftësive për ndërmarrësi. Pjesëmarrësit krijuan plane Start-up dhe mësuam teknika për hartimin e CV-ve dhe përgatitjen për intervista pune. Trajnimi ka ndihmuar në ngritjen e mundësive të punës dhe përfshirjes së personave me aftësi të kufizuara në tregun e biznesit dhe punës, duke u mundësuar atyre të realizojnë potencialin e tyre.



AKTIVITETET KRIJUESE DHE ARTIZANALE

